

BULETIN BINJAKËZIMI

Buletin tremujor i publikuar nga Projekti i Binjakëzimit 'Mbështetje për Statistikat' në Kosovë - projekt i financuar nga programi i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian për shtetet IPA

Rritja e përputhshmërisë me standardet e BE-së në fushën e statistikës

> Ky është buletini i pestë i Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Statistikat" Kosovë (KS 12 IB ST 01).

Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Statistikat e Danimarkës. Gjithashtu, janë të përfshirë ekspertë nga Finlanda, Lituanija, Irlanda Veriore dhe Italia.

Projekti vazhdon tash një vit e tre muaj. Çdo buletin i përgatitur në baza tremujore paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi aktivitetet e realizuara gjatë atij tremujori, në këtë rast Dhjetor 2014, Janar dhe Shkurt 2015.

Informacione mbi projektin

Ka qenë e planifikuar që Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, të zgjasë 24 muaj, deri në Dhjetor të vitit 2015, me një buxhet prej 1.5 milion EUR. Pas diskutimeve me Agjencinë e Statistikave të Kosovës për përkrahje të mëtejme, projekti është zgjatuar edhe për tre muaj dhe do të përfundojë në Mars të vitit 2016. Projektet e Binjakëzimit janë një iniciativë e Bashkimit Evropian, me qëllimin të ndihmojë vendet e reja anëtare, vendet kandidate dhe vendet fqinje të fitojnë shkathtësitë dhe përvojat e nevojshme për përvetësimin, zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit të BE-së. Ky Projekt Binjakëzimi ka për qëllim të përkrahë ASK-në në prodhimin dhe diseminimin e statistikave sipas standardeve të BE-së.

> Projekti mbulon katër komponente:

Komponenti 1. Një Sistem Cilësie për Statistikat. Ky komponent ka për qëllim të fuqizojë kapacitetin e përgjithshëm të ASK-së.

Komponenti 2. Llogaritë Kombëtare. Qëllimi do të jetë rritja e përputhshmërisë me standardet aktuale të BE-së, me fokus te veçantë në fillimin e prodhimit të Llogarive Kombëtare në baza tremujore.

Komponenti 3. Statistikat e Biznesit. Projekti, mes të tjerash, do të punojë me

ASK-në në përmirësimin e Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve, prodhimin e indikatorëve afatshkurtër dhe përmirësimin e Regjistrat Statistikor të Bizneseve.

Komponenti 4. TI dhe Diseminimi. Aktivitetet në komponentin 4 janë dizajnuar për të përmirësuar sistemet e TI-së në ASK dhe cilësinë e diseminimit të statistikave nga ASK-ja.

> Vizita e Llogarive Kombëtare në Statistikat e Danimarkës

Si pjesë e planit të Projektit të Binjakëzimit, janë organizuar edhe vizita zyrtare për katër komponentet e përfshira në projekt. Për Llogaritë Kombëtare kjo vizitë katër ditore u organizua në Janar të vitit 2015 dhe pesë pjesëtarë të Llogarive Kombëtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës vizituan Statistikat e Danimarkës në Kopenhagë. Gjatë kësaj vizite pati një program gjithëpërfshirës, duke mbuluar tema si outputet kryesore të Llogarive Kombëtare dhe lidhjet midis tyre, Llogaritë Kombëtare tremujore, përpilimi i tabelave ofruese-përdoruese. Gjatë vizitës, ekspertët nga institucionet e dy vendeve shkëmbyen përvojat e tyre në Llogaritë Kombëtare, dhe stafi nga Agjencia e Statistikave të Kosovës patën mundësi të informohen rreth procesit të prodhimit në institucionin statistikor të një vendi anëtar të BE-së.

Si rezultat, u vendos me Agjencinë e Statistikave të Kosovës të fillohet të punohet në përpilimin e tabelave ofruese-përdoruese në Kosovë. Tashmë janë planifikuar disa misione për këtë qëllim, që do të zhvillohen gjatë pjesës së



■ Foto nga vizita e Llogarive Kombëtare në Kopenhag

mbetur të projektit. Përpilimi i këtyre tabelave do të rrisë shumë cilësinë e Llogarive Kombëtare në Kosovë.

> 14 misione gjatë tremujorit të kaluar

Deri tani janë realizuar gjithsej 51 misione, 14 nga të cilat gjatë tremujorit të kaluar. Projekti po përparon mirë dhe ka pasur misione në katër komponentet. Në fushën e Llogarive Kombëtare, Projekti i Binjakëzimit ka përkrahur ASK-në në publikimin e versionit të parë të Llogarive Kombëtare tremujore. Në lidhje me Statistikat e Bizneseve, Projekti është fokusuar në veçanti zhvillimin e Regjistrat Statistikor të Bizneseve. Kurse në fushën e Diseminimit, fokusi ka qenë hapja e databankës, që do të realizohet së shpejti.

Gjatë 15 muajve të kaluar, ekspertë nga Danimarka, Finlanda, Italia dhe Lituanija kanë qenë të përfshirë në projekt dhe tremujori i pestë ka qenë një periudhë shumë e ngarkuar. 18 aktivitetet janë planifikuar për dy tremujorët e ardhshëm – përsëri në katër komponentet.



■ Foto nga vizita e Llogarive Kombëtare në Kopenhag

Per Knudsen Resident Twinning Adviser (RTA)

EU Twinning Project
Support to Statistics in Kosovo
Tel. (RKS) +386 (0)49819307
Tel. (DK) +45 28357071

Project information is available from,
the website

WWW.DST.DK/KOSOVO



This project is funded by the European Union



This project is implemented by Statistics Denmark